

## AUTORIZIMI I INFERMIERËVE PËR TË MBAJTUR NË SPITAL PERSONIN NË MJEKIM PËR ÇRREGULLIM MENDOR SI PACIENT I SHTRUAR NË SPITAL

(Paragrafi 5(4) i Aktit për Shëndetin Mendor 1983)

|   |  |
|---|--|
| 1. Emri i pacientit                             |  |
| 2. Emri i personit përgjegjës për mjekimin tuaj |  |
| 3. Emri i infermieres që ju mban këtu           |  |

### Pse nuk mund të dal nga spitali?

Ju mbaheni në këtë spital sipas paragrafit 5(4) të Aktit për Shëndetin Mendor 1983. Kjo është e drejtë ligjore që i jep autorizim infermieres t'ju mbaj në spital derisa t'ju vizitoj personi përgjegjës për mjekimin tuaj ose zëvendësi i tyre. Infermierja mendon se ju keni çrregullim mendor dhe nuk jeni në gjendje të mirë të dilni nga spitali.

“Zëvendësi” nënkupton ai i cili mund të merrë vendim nëse personi përgjegjës për mjekimin tuaj ndodhet diku tjetër.

### Sa kohë do t'më mbajnë këtu?

Ju duhet të qëndroni në këtë spital deri në gjashtë orë derisa personi përgjegjës për mjekimin tuaj ose zëvendësi i tij ju thojnë se mund të dilni. Nëse provoni të dilni nga spitali stafi mund t'ju ndaloj, dhe nëse dilni ata mund t'ju kthejnë mrapsh.

Në rastin tuaj gjashtë orë përfundojnë me:

|      |      |
|------|------|
| Data | Koha |
|------|------|

Nëse personi përgjegjës ose zëvendësi i tij nuk ju kanë vizituar deri më tani, ju jeni të lirë të dilni nga spitali. Por, nëse vendosni të dilni atëherë, ju lutem bisedoni me infermierën apo një anëtar tjetër të stafit.

### Çfarë ndodhë gjatë kohës që mbahem këtu?

Stafi i spitalit do t'ju tregoj lidhur me ndonjë mjekim që mendojnë se keni nevojë. Ju keni të drejtë të refuzoni mjekimin që nuk e dëshironi. Vetëm në rrethana të veçanta, të cilat do t'ju shpjegohen, mund t'ju jepet mjekim pa pajtimin tuaj.

### Çfarë ndodhë më tutje?

Personi përgjegjës për mjekimin tuaj, ose zëvendësi i tyre vendosin se a duhet të qëndroni në spital për një kohë më të gjatë. Ju mund të vendosni të qëndroni në spital vullnetarisht.

Nëse ju edhe më tutje nuk dëshitoni të qëndroni në spital, dhe personi përgjegjës për kujdesin tuaj, ose zëvendësi i tyre, mendojnë se ju jeni tepër sëmurë për të dalur nga spitali, ata duhet t'ju mbajnë këtu sipas një paragrafi tjetër të Aktit për Shëndetin Mendor. Ata do t'ju tregojnë pse dhe sa kohë duhet të qëndroni këtu, dhe do t'ju jepin edhe një fletëpalosje tjetër për t'ju treguar se çfarë do të ndodhë.

Nëse personi përgjegjës ose zëvendësi i tij vendosin se ju nuk keni nevojë të qëndroni në spital, ata ose një anëtar tjetër i stafit do të bisedoj me ju se çfarë ndihme tjetër duhet të merrni.

### A mund të apeloj?

Jo. Edhe pse ju nuk jeni dakord se tani duhet të qëndroni në spital, ju nuk mund të apelonit kundër vendimit për t'ju mbajtur këtu, sipas paragrafit 5(4).

### Njoftimi i anëtarit më të afërm familjar

Një kopje e kësaj fletëpalosje do ti jepet një personi të cilin Akti i Shëndetit Mendor e konsideron si më të afërmin e familjes tuaj.

Është një listë e njerëzve në Aktin e Shëndetit Mendor që konsiderohen si anëtar të familjes suaj. Zakonisht, personi që është në krye të listës është anëtari më i afërt familjar. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë dhe se çfarë të drejtash ka më i afërmi i juaj familjar lidhur me kujdesin dhe mjekimin.

Ne jemi njoftuar se në rastin tuaj, anëtari më i afërt familjar është:

Nëse ju nuk dëshironi që ky person të marrë një kopje të fletëpalosjes, ju lutem tregoni infermieres tuaj ose një anëtar të stafit.

### **Ndërrimi i anëtarit më të afërm familjar**

Nëse mendon se ky person nuk është i përshtatshëm të konsiderohet më i afërmi i familjes tuaj, ju mund të aplikoni tek Gjykata e Qarkut për të konsideruar një person tjetër si më të afërmin tuaj familjar. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë.

### **Letrat e juaja**

Të gjitha letrat e marruara gjatë qëndrimit tuaj në spital do t'ju dorzohen juve. Ju mund t'ju dërgoni letër çdonjërit, përveç ndonjërit që ka pohuar se nuk dëshiron të marrë letra nga ju. Letrat dërguar këtyre personave mund të ndalohen nga stafi i spitalit.

### **Si të ankohem?**

Nëse doni të ankoheni lidhur me ndonjë pakënaqësi që ka të bëjë me kujdesin dhe mjekimin tuaj në spital, ju lutem bisedoni me një anëtar të stafit. Ata mund të rregullojnë këtë çështje. Ata poashtu mund t'ju jepen informacion lidhur me procedurën e ankimit të spitalit, të cilën mund të përdorni për të zgjidhur pakënaqësinë tuaj nëpërmjet të quajturit vendim lokal. Ata poashtu mund t'ju tregojnë për persona të tjerë që mund t'ju ndihmojnë për t'u ankuar.

Nëse mendoni se procedura e ankimit nuk mund t'ju ndihmon, ju mund të ankoheni tek një Komision i pavarur. Komisioni i pavarur e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor, për të siguruar përdorim të drejtë dhe kujdes të duhur ndaj pacientëve gjatë qëndrimit të tyre në spital. Stafi i spitalit mund t'ju jep një fletëpalosje e cila shpjegon se si të kontaktoni me Komisionin.

### **Kodi Praktik**

Kodi Praktik është ai që jep këshilla lidhur me Aktin e Shëndetit Mendor njerëzve të përfshirë në kujdesin tuaj. Ata duhet të marrin parasysh se çfarë thotë Kodi kur të marrin vendim lidhur me kujdesin tuaj. Nëse doni , ju mund të kërkonit të shihni një kopje të Kodit.

**Ndihmë dhe informacion të mëtejshëm**

Nëse ka diçka që nuk kuptoni lidhur me kujdesin dhe mjekimin, një anëtar i stafit do të përpiqet t'ju ndihmoj. Ju lutem kërkoni nga një anëtar t'ju shpjegoj nëse ka diçka në këtë fletëpalosje që nuk kuptoni, ose nëse keni ndonjë pyetje tjetër që nuk iu ka përgjegjur fletëpalosja.

Ju lutem kërkoni një kopje të kësaj fletëpalosje nëse i duhet edhe dikujt tjetër.